



Vdes në QKUK personi që javë më parë u plagos nga policia

KRONIKA | May 31, 2022 - 20:10

SHPËRNDAJE:



Këtë të martë ka vdekur 66-vjeçari me inicialet B.B., i cili javë më parë ishte plagosur nga një zyrtar i Policisë së Kosovës, gjatë një bastisje që po zhvillohej në pronën e tij në Prishtinë.

Ai ka vdekur rreth orës 14:30, në ditën e 24 në mjekimin intensive të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

Lajmin për telegrafin e ka konfirmuar Lavdim Morina, mjek kujdestar në Intensive.

“Po, mund të konfirmoj se sot rreth orës 14:30 ka vdekur pacienti i cili ishte në ditën e 24 në mjekim intensive”, deklaroi Morina.

Ndryshe, Policia e Kosovës gjatë një bastisje të zhvilluar më 8 maj 2022 në Prishtinë, ka hasur në rezistencë nga tashmë i ndjeri, i cili më pas kishte pësuar lëndime si rezultat i plagosjes nga ana e një zyrtari policor.

“Pas disa të shtënave me armë zjarri të raportuar më parë, policia me autorizimin e Prokurorit të Shtetit , ka bërë kontrollimin e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të dyshuarit mashkull kosovar. I dyshuari ka kanosur me armë zjarri zyrtarët policorë duke ua kanosur jetën drejtpërdrejtë, me ç rast në vetëmbrojtje dhe për të vënë situatën nën kontrollë njëri nga zyrtarët ka përdorur armën ndaj të dyshuarit”, thuhej në raportin e policisë.

Si dëshmi materiale policia pati sekuestruar: pesë pistoleta, një AK-47, 694 copë fishekë të kalibrave të ndryshëm, 58 gëzhoja dhe 4 predha. /telegrafi

Të rekomanduara



Arrestohet serbi që u prezantua rrejshëm si...

May 31, 2022



Arrestohet personi që plagosi 25-vjeçarin...

May 31, 2022

Aksident në “Rrugën e Kombit”, makina përplas 8-vjeçarin

KRONIKA | May 31, 2022

Arrestohet vajza që theri me thikë një të mitur në Obiliq

KRONIKA | May 31, 2022

Ngacmoi seksualisht një femër, arrestohet një person në Fushë-Kosovë

KRONIKA | May 31, 2022

Sulmohet një fëmijë nga persona të panjohur në veri të Mitrovicës

KRONIKA | May 31, 2022


I mituri arrestohet në Pejë pasi ishte duke vozitur në gjendje të dehur

KRONIKA | May 31, 2022

Obiliq: Në këmbim të parave, prindërit lejuan bashkëjetesën e fëmijëve të mitur

KRONIKA | May 31, 2022

Më të lexuarat



KRONIKA | May 30, 2022

Polici që plagosi të dyshuarin për vrasjen e rëndë në Ferizaj subjekt i hetimit, ky është dyshimi që rëndon mbi të



KRONIKA | May 29, 2022

Varroset Gazmend Hyseni që u vra të shtunën në Ferizaj



KRONIKA | May 30, 2022

IPK-ja kthen në punë policin që plagosi vrasësin e 30-vjeçarit në Ferizaj



KRONIKA | May 30, 2022

Ende në arrati vajza që theri me thikë 15-vjeçarin në Obiliq



KRONIKA | May 30, 2022

Persona të armatosur grabitin në termocentralin “Kosova A”



KRONIKA | May 30, 2022

Plagoset me “AK-47” një person në Prishtinë